

EDICIONI I TRETË

BULETINI INFORMATIV

(korrik, gusht, shtator)



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



AKK SIGUROHET QË LABORATORËT PËR TESTIMET COVID-19 RESPEKTOJNË KONKURRENCËN E NDERSHME



Që nga fillimi i muajit gusht, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka qenë i angazhuar që të monitorojë sjelljen e laboratorëve privatë, të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e testimeve për virusin SARS-CoV-2.

Monitorimi i këtij tregu është bërë në baza ditore, për t'u siguruar se këta operatorë nuk do të bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës duke bërë ndonjë marrëveshje të ndaluar, praktikë të bashkërenduara apo sjellje abuzive.

Ky proces ka filluar pas një takimi që Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Valon Prestreshi, ka zhvilluar me Ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, më 10 gusht.

Gjatë procesit të monitorimit, zyrtarët e AKK-së kanë grumbulluar të dhëna nga autoritetet përgjegjëse shtetërore dhe laboratorët privatë duke përfshirë çmimin e importit të materialit, çmimin e ofrimit të shërbimit dhe të dhëna të tjera.

Pas analizimit të këtyre të dhënave, AKK ka konstatuar se rreth 120 laboratorët e licencuar për testimet serologjike dhe katër të tjerët për testimet molekulare PCR kanë ofruar çmime të ndryshme të këtij produkti, dhe nuk është identifikuar ndonjë marrëveshje e kundërligjshme në mes operatorëve. Kjo nënkupton se tregu përkatës për këtë produkt është i liberalizuar dhe kjo u mundëson qytetarëve që të zgjedhin ofertën më të përshtatshme për ta.

Përveç monitorimit të sjelljes së këtyre laboratorëve, që nga fillimi i pandemisë AKK ka qenë i angazhuar edhe në drejtime të tjera, përfshirë monitorimin e çmimit të produkteve ushqimore dhe atyre bazë në fillim të përhapjes së pandemisë si dhe analizimin e tenderëve të Ministrisë së Shëndetësisë të nënshkruar gjatë kësaj periudhe.

AKK DHE BQK DAKORDOHEN PËR REFORMA NË INDUSTRIJË E SIGURIMEVE TPL



Kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, është takuar gjatë muajit shtator me Zëvendësguvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Sokol Havolli, me të cilin kanë prezantuar disa reforma që BQK do t'i ndërmarrë në industrinë e sigurimeve në veturë.

Autoriteti i Konkurrencës dhe Banka Qendrore e Kosovës kanë qenë duke e trajtuar këtë industri që nga viti 2019,

kur AKK i kishte ofruar një Rekomandim Profesional BQK-së që ta bëjë liberalizimin e tregut të sigurimit TPL të veturave. Më konkretisht, AKK kishte kërkuar nga BQK (si rregullator i këtij tregu) që të mos bëjë unifikimin e çmimeve të sigurimeve por që ta liberalizojë tregun dhe nga rregullimi aktual të kalohet

në një seri tarifash të lejuara (tavan dhe dysheme). Kjo sipas AKK-së, e shton presionin konkurrues mes operatorëve dhe rrjedhimisht ndikon edhe në uljen e çmimit të produktit.

Në konferencën për media, Zv. Guvernatori Sokoli ka thënë se institucioni i tij dhe AKK kanë pasur komunikim të vazhdueshëm në përpjekje për të gjetur një modalitet për të adresuar çmimin e sigurimit TPL të veturave duke thënë se BQK synon që të bëjë hapa në drejtim të liberalizimit të tregut.

Një nga aktivitetet e rëndësishme të Autoritetit të Konkurrencës është ofrimi i Mendimeve Profesionale ndaj institucioneve qendrore dhe lokale lidhur me politikat e konkurrencës.

ARRIHET PËRPARIM NË HARTIMIN E LIGJIT TË RI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS



Gjatë muajve të fundit, një nga prioritetet e Autoritetit të Konkurrencës ka qenë hartimi i Ligjit të ri për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Për këtë qëllim, një Grup Punues i AKK-së, ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission si dhe zyrtarë të ministrive të linjës, kanë analizuar çdo nen të ligjit aktual dhe kanë propozuar ndryshimet që do të përfshihen në Ligjin e ri.

Ligji i ri, një draft i të cilit është në fazën e diskutimeve publike, është bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Fillimisht, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ishte miratuar në Kuvendin e Kosovës më 2010, ndërsa në vitin 2014 janë amendamentuar disa nene të këtij ligji për t'i garantuar mandat më të gjerë AKK-së.

AUTORITETI DHE ZRRE NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

AuAutoriteti i Konkurrencës dhe Zyra e Rregullatorit për Energji kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi në shtator.

Marrëveshja mes dy institucioneve synon që të krijojë mekanizma dhe platforma konkrete të bashkëpunimit mes dy palëve drejt krijimit të një tregu të qëndrueshëm të energjisë në Kosovë, bazuar në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi me ZRRE-në është nënshkruar vetëm disa ditë pasi që është nënshkruar Marrëveshja për Normalizim Ekonomik në Ëashington, e cila ndër të tjerash thotë se Kosova e Serbia do të diversifikojnë furnizimin e tyre të energjisë.

“Në dritën e këtij zotimi, institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, siç jemi ne, po përgatitemi për formën dhe mënyrën e zbatimit të kësaj pike, në konsultim të ngushtë me Qeverinë e Kosovës”, ka thënë Kryetari i AKK-së, Valon PRestreshi, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.



AKK DO TË MBAJË NJË NUMËR TRAJNIMESH GJATË MUAJVE TË ARDHSHËM



Autoriteti i Konkurrencës është përfitues i një projekti që financohet nga Bashkimi Evropian, që ka për synim ta ndihmojë AKK-në drejt sigurimit të një ambienti konkurrues në Kosovë.

Në kuadër të këtij projekti, gjatë muajve të ardhshëm janë paraparë zhvillimi i një numri të konsiderueshëm të trajnimeve.

Lidhur me këtë, përfaqësues të AKK-së dhe të Projektit kanë diskutuar në fund të muajit shtator. Trajnimet do të zhvillohen nga ekspertë ndërkombëtarë në fusha si zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për politikat e sektorit të telekomunikacionit dhe shërbimeve bankare dhe financiare, ngritja e bashkëpunimit me rregullatorët e tjerë sektorial, manipulimi i ofertave e të tjera.

AVOKOHET PËR POLITIKA TË KONKURRENCËS TEK INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE



Zyrtarët e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të kryesuar nga Komisionerja Fatime Haziri, janë takuar më 29 shtator me përfaqësues të Institucioneve Financiare Jobankare (IFJB), me të cilët kanë diskutuar çështje të ndryshme që lidhen me politikat e konkurrencës.

Ndër të tjerash, zyrtarët e institucionit tonë i kanë informuar zyrtarët e IFJB-së lidhur me marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve, abuzimin me pozitën dominuese si dhe për përqendrimet e ndërmarrjeve.

AKK është i përkushtuar që të avokojë për ngritjen e vetëdijes për politikat e konkurrencës në sektorë të ndryshëm dhe mbetet i hapur që të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm për arritjen e këtij qëllimi.

ZYRTARËT E AKK-SË MARRIN PJESË NË **KONFERENCA** TË NDRYSHME PËR KONKURRENCËN



Zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës kanë vazhduar të marrin pjesë në trajnime dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare lidhur me politikat e konkurrencës.

Në fund të muajit shtator, Inspektorët Hetues Adrian Mustafa dhe Shyhrete Bytyqi kanë marrë pjesë në Seminarin Virtual Njoftues për Stafin e Ri – Procedurat dhe parimet e Ligjit të Konkurrencës.

Z. Mustafa dhe zyrtarë të tjerë të AKK-së kanë marrë pjesë edhe në konferenca të tjera, përfshirë Konferencën e 13-të Vjetore të Konkurrencës për Evropën Qendrore dhe Lindore



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



EU Support to the Kosovo Competition Authority and the State Aid Commission



"Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmëri qëndrimet e Bashkimit Evropian"